



Në përputhje me dispozitat e nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr:

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 02/2014

PROCEDURAT PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË TEK NDRYSHIMI NË FORMËN E BIZNESIT

QËLLIMI

Qëllimi i këtij udhëzimi është që bizneseve të cilat janë të interesuara të bëjnë transferim të pronësisë tek ndryshimi në formën e biznesit, t'u ofrojmë informata se çfarë hapa duhet ndjekur për ta bërë një ndryshim të tillë dhe njëkohësisht stafit të Zyrave Regjionale të Shërbimit të Tatimpaguesve në ATK dhe stafit të Zyrave për Regjistrimin e bizneseve në ARBK, t'u ofrojë sqarime lidhur me këtë çështje dhe hapat që duhet të ndërmarrin.

MUNDËSIA PËR NDRYSHIM NE FORMËN E BIZNESIT / PRONËSISË

Të gjitha bizneset të cilat dëshirojnë të bëjnë ndryshimin në formën e biznesit apo ndryshimin e pronësisë së biznesit, paraprakisht duhet të interesohen dhe të rregullojnë (pastrojnë) gjendjen e tyre në ATK. Mundësia që një biznes të bëjë ndryshimin e formës së biznesit apo ndryshimin e pronësisë, do të jetë e aprovuar vetëm atëherë kur biznesi ka të deklaruar të gjitha periudhat tatimore të kërkuara dhe ka të shlyera të gjitha detyrimet tatimore. Pra, vetëm në raste kur biznesi ka të paguara të gjitha detyrimet tatimore, ATK do ta pajisë me Vërtetim Tatimor, i cili do të mundësojë ndryshimin e formës së biznesit apo ndryshimin e pronësisë së biznesit.

PROCEDURAT PËR NDRYSHIMIN E FORMËS SË BIZNESIT / PRONËSISË

Në përputhje me paragrafin 6, Nenin 11 i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe paragrafin 3, Nenin 11 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010, Administrata Tatimore e Kosovës në bashkëpunim me ARBK, nxjerr këtë Udhëzim për ndryshimin e formës së biznesit / pronësisë së biznesit, me anë të të cilit përshkruhen kushtet se kur mund të bëhet ndryshimi i formës së biznesit / pronësisë, si dhe procedurat që duhet ndjekur.

Ndryshimi i formës së biznesit / pronësisë, mund të ndodhë atëherë kur të jenë plotësuar kushtet e parapara në Ligjin e lartcekur, citojmë:

